


DATE/A:	18.12.2024
PËR/ZA/TO:	Zyra e Kryetarit
PËRMES/PREKO/T HROUGH:	Drejtoria e Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Haxhi Bejta
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	PLANI I PUNËS I DREJTORISË SË PROKURIMIT PËR VITIN 2025



Në mbështetje dhe me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092-Ligji për Prokurim Publik në Kosovë ) Drejtoria e Prokurimit ua prezanton :

**PLANIN E PUNËS TË DREJTORISË SË PROKURIMIT PËR VITIN FISKAL 2025**

Drejtoria e Prokurimit në Komunën e Skenderajt është themeluar.Bazuar në obligimet ligjore të Drejtorisë po e prezanojm planin e punës për vitin fiskal 2024-të dhe aktivitetin e saj të punës mbështet në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, i shpallur me dekretin Nr/L041-2015, datë 29.12.2015( në tekstin e mëtejme LPP-së),Ligjet,Rregulloret, aktet dhe vendimet tjera të aprovuara Agjencioni Qendror i Prokurimit Publik ( në tekstin e mëtejme AQP-së), Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik( në tekstin e mëtejme KRRPPsë) si dhe vendimeve dhe akteve tjera të organeve komunale, Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë e Financa dhe organeve tjera relevante.

Me këtë Plan identifikohen në detaje të arsyeshme të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Skenderajt planifikon t'i realizoi gjatë vitit fiskal 2025-të,për gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

Sipas nenit 8 paragrafi 1 të LPP-së jo më pak se 30 ditë kalendarike para fillimit të viti fiskal 2025, secili Autoritet Kontraktues duhet të përgatis Planifikimin Paraprak të Prokurimit, në të cilin do duhej të identifikoheshin në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet ,punët dhe Hartimin e Projekteve që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi, ndërsa sipas nenit 8 paragrafi 2 të LPP-së Brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, Autoriteti Kontraktues do të përgadisë dhe do të dorëzoi Agjencionit Qendrorë të Prokurimeve ( AQP-së ) një planifikim përfundimtarë me shkrim, i cili identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, punët dhe shërbimet që që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi gjatë viti fiskal në fjalë.

Drejtoria e Prokurimit ka dërguar planifikimin preliminar tek Zyrtari kryesor administrative në afatin ligjor meqenë se Planifikimi është ngushtë i lidhur me përgatitjen e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit dhe buxhetit komunal për vitin fiskal 2025 si dhe me aktivitetin e prokurimit që Drejtoria e Prokurimit do të ndermerr gjatë vitit 2025.

Plani në përgjithësi do duhej të jetë i harmonizuar dhe të korrespondoj me kufijtë e buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin fiskal 2025, për të gjitha shtyllat e buxhetit, si vijon :

- Zyra e Kryetarit-
- Administrata dhe personeli
- Inspektimet
- Zyra e Kuvendit komunal
- Buxhet dhe financa
- Shërbime publike,mbrojtje c
- Zyra komunale për komunitete
- Bujqësia , pylltaria dhe Zhvillimi rural
- Zhvillim ekonomik
- Kadastra dhe Gjeodezia
- Planifikimi urban dhe mjedisi
- Shëndëtesia dhe mirëqenja social
- Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale
- Kultura , Rinia dhe sporti
- Arsimi dhe Sheknca

Po ashtu, në pajtim me dispozitat e nenit 39 të LPP-së,Drejtoria e Prokurimit Skenderaj do të përgadis dhe dërgoi për publikim në KRPP edhe Njoftimin Paraprak. Ky Njoftim publikohet kur një Autoritet Kontraktues ka për qëllim dhënie, gjatë periudhës së ardhëshme12 mujore, të një ose më shumë kontratave të furnizimeve, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose së bashku, kanë një vlerë të parashikuar prejpesëqindmijëeuro (500,000.00€ ).

Përmes këtij Njoftimi, veç KRPP-së dhe AQP-së, informacione të sakta për synimet e aktiviteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues, mundë të sigurojnë edhe Operatorët Ekonomik të interesuar.

Planifikimi përfundimtarë, si dokument i aprovuar nga organi kompetent i Autoritetit Kontraktues do të përgaditet në menyre elektronike dhe do të jetë pjesë përbërëse e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit.

Në vazhdim në Planin e vet të punës, Drejtoria e Prokurimit do të zhvillojë procedurat sipas objektivave të Drejtorive Komunale, gjatë vitit fiskal 2025, sipas kategorive, punë, shërbime dhe furnizime, për t'i përmbushur kërkesat gjegjësisht planifikimet e gjitha shtyllave buxhetore – njësisive shpenzuese të Autoritetit Kontraktues. Ashtu sikur se është rregulluar me dispozitat e LPP-së, asnjë informatë mbi aktivitetet e planifikuara të prokurimit të Autoritetit Kontraktues nuk duhen të bëhen publike apo t'i zbulohen dikujt para publikimit të njoftimeve standarde. Arsyeja për këtë është mbrojtja e parimit të trajtimit të barabartë, i cili në këtë moment donë të thotë se informatat mbi një aktivitet të veçantë të prokurimit do t'i zbulohet operatorëve ekonomik në të njëjtën kohë. Me gjithë obligimin sikurse u theksua më lartë, Drejtoria e Prokurimit siguron se të gjitha iniciimet e procedurave të aktivitetit të prokurimit do të zbatohen dhe kryhen sipas LPP-së, Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondar në fuqi duke siguruar konkurrencë të drejtë, shfrytëzim sa më të mirë të parasë publike, efikasitet dhe ekonomizim në zbatimin e drejtë të procedurave të prokurimit , trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik.

Një nga detyrat permanente të Drejtorisë së prokurimit do të jetë transparenca në zbatimin e gjitha proceduarve sipas LPP-së, duke filluar nga:

Proceduar e hapur dhe e kufizuar  
Procedura konkurruese me negociata  
Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës  
Procedura Konkursi i projektimit  
Procedura e kuotimit të çmimeve, dhe  
Procedura e prokurimit në vlera minimale.

Varësisht nga aplikimi i cilës do nga këto procedura, Drejtoria e prokurimit do të zbatoi dispozitat ligjore, konform LPP-së dhe legjislacionit në fuqi , se cili proces i prokurimit do të administrohet përmes 8 hapave, si në vijim :

Hapi 1 Planifikimi i Prokurimit  
Hapi 2 Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës  
Hapi 3 Përcaktimi i Vlerës së Prokurimit  
Hapi 4 Përgatitja e Dosjes së Tenderit  
Hapi 5 Publikimi  
Hapi 6 Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve  
Hapi 7 Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës  
Hapi 8 Menaxhimi i Kontratës

**Cikli I Prokurimit të një aktiviteti i prokurimit duhet të kalojë nëpër 39 faza e të cilat në Platformën e E-prokurimit dhe kanë afatin kohor se kur duhet filluar dhe përfunduar.**

Edhe gjatë viti fiskal 2024 detyrë parësore e Drejtoria e Prokurimit do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore l gjitha kërkesave të njëjësive shpenzuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit, si dhe përgatitja e planifikimit përfundimtar për gjitha llojet e prokurimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2024 kryejra e pagesave përmes Sistemit të pagesave (urdherblejret) si me poshte:

#### **KONTRATA PËR FURNIZIM**

Per vitin 2025 jane planifikuar te zhvillohen procedurat e prokurimit perafersisht prej 43 procedura.

#### **KONTRATË PËR SHËRBIME**

Per vitin 2025-te jane planifikuar te zhvillohen procedurat e prokurimit per kontrata per sherbime perafersisht, 22 procedura.

#### **KONTRATA PËR PUNË**

Per vitin 2025-të jane planifikuar te zhvillohen procedurat e prokurimit per kontrata per pune perafersisht , 17 procedura.

Për iniciimin e aktivitetit të proceduarve të prokurimit, Drejtoria e Prokurimit, në harmoni me dispozitat e LPP-së, do të zhvilloi procedurën, si vijon:

- Vlerësimi i nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve do te interesohet qe (Deklarata e nevojave dhe disponueshmerise se fondeve te nenshkruet nga personat e autorizuar) sipas nenit 9 te LPP.
- Llogaritja e vlerës( para llogaria) dhe klasifikimi i kontratës, sipas nenit 16, 17 dhe 18 të LPP-së ;
- Përcaktimi i procedurës së prokurimit sipas nenit 19 të LPP-së ;
- Përgatitja e dosjes së tenderit, sipas nenit 27 të LPP-së ;
- Dërgimi për publikim në Platformën elektronike i njoftimit për kontratë sipas nenit 40 të LPP-së ;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderit sipas neni 58 dhe 59 të LPP-së ;
- Vendosja në Platformen e e- prokurimit Vendimin mbi OE të rekomanduar për kontratë mbi rezultatet e vendosjes për përzgjedhje e operatorit Ekonomik të suksesshëm;
- Informimi përmes letrave standarde për njoftim te të gjithë Operatoreve ekonomik pjesëmarrës në se cilën procedure te prokurimit --Vendosja ne e-prokurim
- Lejimi l Qasjes në dokumente të gjithë OE-ik , sipas LPP-së,-Vendosja në e-prokurim
- Kërkesat për Rishqyrtim shqyrtimi dhe kthimi l pergjigjejeve ne lidhje me kërkesat për rishqyrtim,

- Ankesat eventuale nga Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit dhe procedimi lidhur me të njëjtat;
- Pezullimi I aktivitetit të prokurimit sipas ligjit të Prokurimit.-Ri-vlerësimi
- Anulimi I aktivitetit të prokurimit sipas LPP-së,
- Përgaditja e Njoftimit për nënshkrim të kontratës –kërkesa për caktimin e Menaxherit ,
- Nënshkrimi dhe përkujdesja lidhur me zbatimin efektiv të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së.
- Urdhërblert për pagesat përmes procedurave të prokurimit.

Për të pasur një efikasitet sa më të lartë në zbatimin e detyrave të punës si dhe për të përmbushur objektivat e saja të punës, Drejtoria e Prokurimit, në planin e vet të punës, edhe për vitin 2025, ashtu sikurse parashohin edhe dispozitat e nenit 25 të LPP-së, parasheh nevojën e trajnimit në vazhdimësi të stafit të prokurimit duke ditur se punët dhe detyrat e punës në zyrën e prokurimit janë krejtësisht profesionale po ashtu pritet edhe ndryshimet e LPP-se kjo e ndihmon stafin e Drejtorisë së prokurimit përfeksionimin e mëtejshëm të personelit, si trajnime të organizuara dhe të obliguara nga KRPP në bashkëpunim me IKAP-in ( Instituti Kosovar i Administrimit Publik ) ashtu edhe trajnime për zbatimin e teknologjisë informative dhe trajnime tjera nga Organizata të ndryshme si USAID dhe Organizata tjera që merren me fushën e Prokurimit.

Drejtorja e Prokurimit, në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësisë të saj që i ka në bazë të ligjit, udhëzimeve administrative nga KRPP-ja dhe akteve normative komunale do të përgatitë dhe prezantoi për shqyrtim pranë organeve kompetente, si atyre qendrore dhe atyre komunale, raporte mbi prokurimet për periudhën gjashtëmujore dhe përfundimtare-vjetore ,për gjitha shtyllat e buxhetit.

Gjithashtu, në fushën e vetë të përgjegjësisë, Drejtoria e Prokurimit edhe pse me një staf jo të mjaftueshëm , personeli i sajë do të marrë pjesë, do të kontribuoj dhe implementoi vendimet e Kryetarit Komunës për çështjet që janë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Prokurimit , duke i ofruar atij informatat raportet e nevojshme lidhur me ecurinë e punës dhe për procesin e vendimmarrjes.

Kujdes të vazhdueshëm do të kushtohet edhe implementimit të kontratave të lidhura në viteve të kaluara të cilat sipas planifikimit dhe planit dinamik duhen të përfundohen në vitet vijuese, 2025 ose 2026.Në këtë drejtim duhet të ekzistoj një bashkëpunim shumë i ngushtë me drejtorinë komunale inicuese të aktivitetve të tilla dhe konsiderojme se është e nevojshme një zyrtar për Menaxhimin e Projekteve në kuadër të Drejtorisë së Prokurimit apo Autoritetit Kontraktues për të evidentuar dhe siguruar shumën e mjeteve financiare për përmbushjen me sukses dhe në kohë të kontratave dhe për të ndihmuar Menxheret për Menaxhim të afateve kohore të kontratave.

Një bashkëpunim të ngushtë Drejtoria e Prokurimit do ta ketë edhe me AQP-në për të ofruar informata të nevojshme për të, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevojat e autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror,ashtu sikur se është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së.

Drejtoria e Prokurimit do të bashkëpunoi ngusht edhe me KRPP, IKAP, OSHP, USAID-in dhe organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e Marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Komunës së Skenderajt dhe USAID-it, e cila në focus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës në Komunave të Kosovës, me theks të veçantë trajnimin e stafit kryerjen me sukses të aktiviteteve të punës në kuader të Prokurimit, hapje tenderëve, vlerësim dhe menaxhim kontratave dhe punë tjera të nevojshme pasi që ligji, rregulloret, udhëzimet administrative dhe nxjerrja e vendimeve nga ana e Komisionit rregullativ për prokurim publik, AQP dhe autoritet tjera kërkojnë njohuri profesionale po ashtu edhe përgatitje të saftit të prokurimit.

**Drejtoria e Prokurimit:**

**Përgaditë: Hafseje Zejnullahu,**

**Kontrolloi: Drejtori I prokurimit**

**Haxhi Bejta**